

Shtojca 20

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE  
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik x

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Classic sh.p.k

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Classic sh.p.k

Nuis/Nipt

J91909004J

Adresa

Aut. TR-DR, Km1

Shqiperi

1004

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

Tirane

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

00355682032050

E-mail

Artan.qesko@classic-volkswagen.com.al

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

(Artan Qesko)

28.12.2023

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

**1. Numri i referencës së procedurës/Lotit**

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

REF-85607-10-27-2023

## 2. Lloji i Procedurës

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

Procedurë e hapur

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkurruese me negociim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negociim me shpallje  
paraprake të njoftimit

Procedurë me negociim pa shpallje  
paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulence

Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga  
procedurat e prokurimit të parashikuara në  
LPP

## 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

**Albpetrol sh.a**

---

## 4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

*(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

**96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH,**

---

## 5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).*

**Marrje me qira të mjeteve të transportit**

---

## 6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*(Data (viti/muaji/dita)*

28.12.2023

---

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit  
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

8. Data e nënshkrimit të kontratës  
(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për përvetshëmëri të kontratës)

---

### Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)  
Rishikim specifikimesh teknike

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

Si pale e interesuar në proces për procedurën e prokurimit publik me objekt "Marrje automjete me qera" me fond limit 96 992 000 lekë me autoritet kontraktor "ALPETROL" sh.a donit t'ju vinim në dijeni mbi fakte të cilat lidhen me vijim e kësaj procedure prokurimi.

Ndodhur në kushtet e një vendimarrje nga ana juaj Ju paraqesim argument mbi Vendimin nr.1282/2023 të datës 12.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe shtojcës së publikuar nga ana juaj mbi zbatimin e këtij vendimi.

Ajo që bie në sy dhe është ndryshimi i specifikimit teknik i mjetit mbi cilindraten: Automjetet tipi Pick UP dopjo Kabine sasi 14 katërbëdhjete copë të reja me kilometra zero ku specifikimi teknik Cilindra ishte min 2200 cc dhe në bazë të ndryshimit sipas Shtojcës së datës 18.12.2023 është bërë cilindra max 2000cc ndryshim i cili është në shkelje të hapur të konkurrencës në një procedurë prokurimi, duke cuar procesin në një operator të vetëm.

Ju në vendimin tuaj shprehni se: Për sa më sipër, Komisioni gjykon, se për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatorët ekonomikë do të sigurojnë mall cilësor në përputhje me specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, por një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët

5

ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitja e pjesëmarrësve të biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të justifikojë kërkesën për "Cilindratën" për secilën prej automjeteve objekt-prokurimi, në përputhje me nenin 36 të LPP-së si më sipër cituar. Akoma me tej shpreheni se : Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë si Mitsubishi, Toyota, Mercedes Benz, SsangYong etj, për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Pra, një anë shpreheni se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kritere dhe specifikime teknike të cilat nuk të çojnë drejt një marke të caktuar apo që mund të jenë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë prokurimi të operatorëve të interesuar dhe në anën tjetër pranoni ankesën e operatorit mbi ndryshimin e specifikimeve teknike duke orientuar procesin drejt një marke apo një operatori, duke diskriminuar dhe përjashtuar operatorët e tjerë pjesëmarrës.

Specifikimi max 2000cc është kufizues dhe përjashtues gjë e cili është shprehur shumë qartë dhe në vendimin e KSHA ku ka argumentuar mbi këtë specifikim konkretisht: KSHA vlerëson se vendosja e kriterit "Cilindrata min 2200 cc", është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj, parim i përcaktuar në dispozitën e LPP, paragrafi 2, e pikës 1, të nenit 36, në të cilën parashikohet që: "Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj." KSHA arsyeton se kërkesa e OE ankimes për ndryshimin e cilindrates së kërkuar në maksimumi 2000 cc është e paargumentuar dhe bie ndesh edhe me kërkesat e tij për tipet e tjera të mjeteve të kërkuara në pikat e tjera të ankesës. Për këto mjete OE ankimes kërkon që cilindrata e mjetit të kërkohet në minimumin e një vlere të caktuar dhe jo në maksimumin e saj. Pra, OE ankimes është konfuz në kërkesën e tij dhe nuk është koherent, në këtë rast kërkon që cilindrata të jetë në maksimumin 2000 cc, duke ofruar mundësinë e ofertimit të mjeteve me cilindrata shumë më të ulët, gjë që bie ndesh me qëllimin, logjikën dhe objektin e kontratës.

Vendosja e kriterit Max 2000cc orienton procesin e këtij prokurimi drejt një marke, drejtë një operatori të vetëm .

Ndodhur në këto kushte duke u nisur nga interpretimi i bërë nga ana juaj mbi kriterin e sipër cituar duke u ndodhur në vijim të procesit mbi lejimin ose jo të heqjes së pezullimit për këtë procedurë prokurimi lutemi të shifet ndryshimet e bëra në shtojcë nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me përcaktimet ligjore të LPP si dhe mbi arsyetimin tuaj me qëllim pjesëmarrjen e një numri të gjerë konkurentesh, qe do te thote kriteri max 2000 cc te behet min 2000 cc.

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

- Pavlefshmëri kontrate

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### 3. Rrethanat dhe faktet

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

### 4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

### 5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

---

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

---

---

7. Lista e informacionit konfidencial:

---

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

*Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik*

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit  
Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

